



Hapja e një faqeje të re:

Armët e Vogla dhe të Lehta në Shqipëri

Falenderime

Komisioni Global për Parandalimin e Konfliktëve i Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar financoi përgatitjen e këtij raporti, dhe Saferworld i është mirënjohëse për mbështetjen e tij bujare. Ky raport u shkrua dhe studiua nga Paul Holtom, me Henry Smith, Bernardo Mariani, Simon Rynn, Larry Attree dhe Juliana Sokolová. Blendi Kajsio drejtoi kërkimet dhe analizimet e dorës së parë në Shqipëri dhe hartoi raste studimore në partneritet me Elona Selamaj dhe Shkelqim Sina. Instituti i Vezhgimeve dhe Opinioneve drejtoi një studim mbi familjen dhe diskutimet e fokus grupeve. Henry Smith dhe Simon Rynn drejtuan projektin për shkrimin e raportit, duke dhënë komente dhe udhëzime të kërkimeve gjatë gjithë procesit të të shkruarit. Larry Attree u mor me studime dhe redaktime shtese dhe shkruajti pjesën mbi armëmbajtjen pa leje. Mes shume individëve – bërë të njohur edhe në listen e burimeve në fund të raportit – të cilët vullnetarisht dhanë informacione dhe kohë të paçmueshme, grupi i studimit është veçanërisht mirënjohës për mbështetjen e Kol Todi Grazhdani i Drejtorisë së Policimit në Komunitet dhe Grumbullimit të Armëve, Kol Haxhi Asllani dhe Kol Sokrat Papadhima të Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Integritetit në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Lawrence Doczy i Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara. Gjithashtu i jemi mirënjohës për ndihmën dhe informacionin e dhënë Agron Sojati i Qendrës SECI, Helidon Bektashit dhe kolegëve në Polici, Adrian Wilkinson i SEESAC, Gerti Veshaj i Qendrës së Edukimit për Paqe dhe Çarmatim, Kenn Underwood dhe Genci Kojdheli.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	i
Akronime dhe Shkurtime	v
Harta	vi
1 Sfondi dhe Metodologjia	1
1.1 Sfondi	1
1.2 Metodologjia	2
1.3 Hyrje	3
1.4 Shqiperia ne shekullin e njezete	4
1.5 Piramidat dhe Kallashnikovet: pasiguria civile ne 1997	5
1.6 Trafikimi dhe konflikti rajonal	7
1.7 Krimi i Organizuar dhe korrupsioni	9
1.8 Reforma ne Polici	11
1.9 Privatizimi i sigurise	12
1.10 Ndikimi politik dhe social i reformes ushtarake	14
1.11 Armet, grushtet e shtetit dhe zgjedhjet	15
1.12 Transparenca	16
2 Pasojat e Armeve te Vogla dhe te Lehta (AVL)	18
2.1 Fatkeqesite nga armet e zjarrit	19
2.1.1 Vrasjet me arme zjarri	20
2.1.2 Vetvrasjet me arme zjarri	21
2.1.3 Vdekjet aksidentale te lidhura me armet e zjarrit	22
2.2 Plagosjet me arme zjarri	22
2.3 Dhuna në familje	26
2.4 Krimet e raportuara dhe normat e viktimizimit	27
2.4.1 Grabitja me armë dhe kërcënimi	30
2.4.2 AVL-të në gjakmarrjet, hakmarrjet dhe ndikimi i tyre më gjerë	31
2.4.3 Perceptimet për korrupsionin dhe krimin e organizuar	34
2.4.4 Perceptimet për Policinë	35
2.5 Incidentet e shkaktuara nga AVL në raportet e medias	36
3 Studimi mbi Shpërndarjen e Armëve të Vogla dhe të Lehta	39
3.1 Armët e MM	40
3.2 Arsenali i MB	41
3.3 Kompanitë e Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike (KRSF)	42

3.4	3.4 Përlogaritja e numrit të AVL të trafikuar	42
3.4.1	Perceptimi i trafikimit	48
3.5	Mbajtja e armëve të vogla dhe të lehta nga civilët	48
3.5.1	Mbajtja e armëve me leje nga civilët	48
3.5.2	Armët e mbajtura pa leje	49
3.5.3	Blerja e armëve pa leje	54
3.5.4	Perceptimet mbi mbajtjen e armëve të vogla dhe të lehta nga popullsia civile	56
3.5.5	Arsyet për mbajtjen e armëve të vogla dhe të lehta	63
	4 Legjislacioni dhe kornizat rregullatore në lidhje me armët e vogla dhe të lehta	66
4.1	Licensimi i eksporteve dhe importeve	66
4.2	Korniza Anti-trafik	68
4.3	Asgjësimi i armëve të vogla dhe të lehta dhe municioneve	69
4.4	Amnistia e AVL dhe legjislacioni e struktura e grumbullimit	70
4.5	Baza ligjore për kontrollin e KRSF-ve	70
4.6	Legjislacioni i mbajtjes së armëve nga civilët	71
	5 Kapaciteti për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta	74
5.1	Kapaciteti kombëtar	74
5.1.1	Ministria e Mbrojtjes	74
5.1.2	Ministria e Rendit Publik/ Ministria e Brendshme	92
5.1.3	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	98
5.1.4	Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ)	99
5.1.5	Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe roli i OJQ-ve	100
5.1.6	Bashkëpunimi ndërinstitucional (midis agjencive)	101
5.1.7	Bashkëpunimi Ndërkombëtar	104
5.2	Asistenca Ndërkombëtare	107
5.2.1	Asistenca ndërkombëtare: asgjësimi i AVL-ve dhe municioneve të tepërta dhe menaxhimi i rezervave	107
5.2.2	Asistenca ndërkombëtare: menaxhimi i kufijve dhe anti-trafikimi	109
	6 Amnistitë ndaj AVL-ve dhe grumbullimi i armëve	114
6.1	Amnistia ndaj AVL-ve dhe legjislacioni e strukturat për grumbullimin	114
6.2	Bazat ligjore për amnesti ndaj AVL-ve dhe grumbullimi i armëve	114
6.3	Sipërmarrja për grumbullimin e armëve	116
6.3.1	Qëndrimi i Qeverisë	116
6.3.2	Kontributi i UNDP	118
6.4	Rezultatet e amnitisë/proceset e grumbullimit të armëve	122
6.5	Mësime nga përvoja shqiptare	124
6.5.1	Vendosja e një baze të rregullt, të qarte e të mirëbashkërenduar për mbledhjen e armëve	124
6.5.2	Sigurimi i zbatimit të ashpër, të ndershëm dhe transparent të ligjit	125
6.5.3	Ruajtja e aftësive dhe motivimit	126
6.5.4	Fitimi i besimit tek mbledhja dhe mbledhësit e armëve	127
6.5.5	Një përjasje ndryshe	127
6.5.6	Stimujt e bazuar ose përjasjet e detyruara	129
	7 Mundësi për të ardhmen	130
APPENDIX 1:	Tabela e transferimeve të AVL-ve, e ërgatitur në bazë të dokumentacionit nga transferimet e MEICO-S	132
APPENDIX 2:	Bibliografia	134

Përmbledhje ekzekutive

HAPJA E NJË FAQEJE – ARMËT E VOGLA DHE TË LEHTA NË SHQIPËRI, është një raport i përfundimeve të studimit të kryer mbi armët e vogla dhe të lehta dhe mbi çështjet e sigurisë në Shqipëri nga periudha prill deri në shtator 2005. Studimi u krye nga organizata joqeveritare me seli në Londër, Saferworld.

Raporti është një kontribut drejt zhvillimit të një politike reaguese ndaj problemit të dukshëm të AVL-ve me të cilin është duke u përballuar Republika e Shqipërisë pas krizës së 1997-ës gjatë së cilës qindra-mijra armë u grabitën nga magazinat e shtetit. Ai pasqyron arritjet e deritanishme të Qeverisë Shqiptare, organizatave ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile në luftën ndaj AVL-ve dhe identifikon sfidat që ende shtrihen para tyre. Përfundimet kryesore të raportit u shqyrtuan gjatë një serie takimesh me një numër të madh zyrtarësh nga Qeveria Shqiptare dhe organizatat ndërkombëtare dhe gjithashtu gjatë një tavoline të rrumbullakët ndër-ministore në Tetor 2005. Raporti final reflekton komentet e marra gjatë këtyre konsultimeve. Një letër e veçantë udhëzuese që përmban rekomandimet e ekipit të studimit për rritjen e kontrollit të AVL-ve është shtuar si një dokument shoqërues i këtij raporti dhe është paraqitur për tu përdorur nga Qeveria Shqiptare.

Përfundimet kryesore të raportit janë si më poshtë:

Impakti i perceptuar i armëve të vogla dhe të lehta (AVL)

- Edhe pse impakti direkt i AVL-ve në krimin dhe shëndetin publik ka qenë një problem shqetësues në fund të viteve 1990, numri i fatkeqësive që i atribuohen keqpërdorimit të armëve ka rënë në mënyrë konsistente që atëherë.
- Një e treta e qytetarëve shqiptarë mendon se është e pranueshme të mbash një armë kur nuk zbatohet ligji, kur ka mungesë stabiliteti politik ose sepse kanë të tjerët. Motivet e tjera të përhapura për mbajtjen e armëve përfshijnë frikën nga mungesa e stabilitetit politik dhe një nevojë të perceptuar për hakmarrje
- Megjithë progresin në trajtimin e gjaksive, lindja dhe rëndësia e tyre e vazhdueshme në shoqërinë shqiptare është një çështje shqetësuese dhe një nxitës domethënës për përdorimin e armëve
- Mosmarrëveshjet mbi pronat, xhelozia, alkoli dhe depresioni janë arsytet e cituara më shpesh në median shqiptare si arsye që bëjnë që njerëzit t'i drejtohen përdorimit të armëve të zjarrit
- Shumë shqiptarë janë të vetëdijshëm se mbajtja e armëve sjell rreziqe, megjithatë kjo dijeni nuk shërben mjaftueshëm si një nxitës për shumë zotërues armësh pa leje që t'i dorëzojnë armët e tyre gjatë amnistive të dhëna nga qeveria. Kjo tregon se shumë shqiptarë janë mësuar tashmë me praninë e armëve në shtëpitë dhe komunitetet e tyre
- Shumë vrasje në Shqipëri kryhen duke përdorur armë zjarri dhe shumica e tyre ndodhin brenda familjes

- Djemtë adoleshentë dhe në të njëzetat janë grupi që ka më shumë të ngjarë të përfshihet keqpërdorimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta.
- AVL-të shpesh përdoren për të kryer akte dhune brenda familjes dhe, sipas grupeve të grave, dhuna në familje është një problem serioz të cilit nuk i është dhënë vlerësim i mjaftueshëm nga institucionet e zbatimit të ligjit dhe ato të drejtësisë
- Raportet e medias tregojnë se në disa raste, punonjësit e policisë dhe rojat private të sigurisë kanë abuzuar me armët e dhëna nga punëdhënësit e tyre ndërsa kanë qënë jashtë shërbimit
- Historikisht, mbajtja e varfër e të dhënave nga policia, spitalet, zyrat e mjekëve ligjorë dhe gjykatat pengon analizën krahasuese dhe zhvillimin e reagimeve të bazuara në prova të politikave ndaj problemeve të AVL-ve. Metodatat e përdorura për të përpiluar informacionin gjithashtu variojnë, dhe cilësia e të dhënave zyrtare mbi plagosjet e lidhura me armët e të zjarrit ndryshon përgjatë vendit.

Shpërndarja e AVL-ve brenda Shqipërisë

- Duke bashkëpunuar me organizata ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile, Qeveria Shqiptare ka ndihmuar në inicimin e përqasjeve të reja për mbledhjen e armëve si përqasja 'armët në këmbim të zhvillimit e cila që atëherë është ndërmarrë në të gjithë botën.
- Megjithë afërsisht një dhjetëvjeçar të organizimit të aktiviteteve të grumbullimit të AVL-ve gjatë të cilit rreth janë mbledhur rreth 200,000 armë nga civilët është llogatritur se një numër i ngjashëm i AVL-ve pa leje (rreth 200,000 copë) është akoma në duart e civilëve.
- Ka një perceptim të përhapur mes publikut të gjërë se politikanët dhe biznesmenët kanë akses të lehtë tek AVL-të.
- Përvec armëve të demonstruara nga policia dhe ushtria, AVL-të zakonisht janë më të dukshme për publikun gjatë festave.
- Riorganizimi i vazhdueshëm i Forcave të Armatosura shqiptare e ka vështirësuar identifikimin si të numrit të armëve të kërkuara për shërbim në një kohë të caktuar dhe numrin e njësive të tepërta të mbajtuara aktualisht nëpër magazina. Megjithatë, është llogaritur se ushtria aktualisht mban rreth 80–140,000 njësi AVL të tepërta
- Ekziston një treg i paligjshëm ruajtjeje dhe sigurie fizike, parallel me atë të rregulluar nga shteti. Në tregun e paligjshëm, individët vihen në dispozicion si roja sigurie kundrejt pagesës, duke sfiduar kështu kompanitë e regjistruara të ruajtjes dhe sigurisë fizike
- Nën kornizën aktuale ligjore rojet private të sigurisë lejohet të përdorin pushkë luftarake në punën e tyre. Armët luftarake janë të papërshtatshme për qëllime të këtitlla dhe Ministria e Brendshme ka plane për të kufizuar përdorimin e tyre në të ardhmen.
- Pavarësisht nga rregulloret e Ministrisë së Brendshme lidhur me magazinimin e armëve dhe municioneve, ende ka raste në të cilat zotëruesit shqiptarë të armëve i ruajnë këto armë në një mënyrë të pasigurt.

Menaxhimi dhe siguria e rezervave

- Forcat e Armatosura Shqiptare kanë reduktuar në mënyrë të konsiderueshme numrin e depove magazinuese nga 167 në 1998—ën në 57 në 2005, duke përmirësuar kështu sigurinë e rezervave. Megjithatë edhe pse shumë nga depot e magazinimit të Ministrisë së Mbrojtjes përdorin procedura të sigurimit të rezervave, nuk ka asnjë qendër të vetme që të jetë tërësisht konform standarteve të kërkuara për sigurinë dhe menaxhimin efektiv të rezervave
- Si pasojë e mbingarkimit historik dhe zhvendosjes së stokeve të vjetra Ministria e Mbrojtjes klasifikon aktualisht gjysmën e të gjitha depove të saj të municionit si të një rreziku të lartë për detonim. Kjo paraqet një kërcënim serioz për shëndetin publik, veçanërisht në lidhje me faktin se vëndet e banimit nganjëherë janë ndërtuar në

mënyrë të rrezikshme pranë vendeve të rezervave dhe magazinimit, në kundërshtim me ligjet e planifikuara

- Një nivel i panjohur rreziku paraqitet nga pakot “e përziera” të municionit të pasisteluar i dorëzuar gjatë grumbullimeve të armëve që ende nuk është ndarë sipas tipit dhe si rrjedhojë nuk mund të magazinohet sipas shkallës të rrezikut.
- Pavarësisht zbatimit të një sistemi llogarie elektronik për AVL-të në Ministrinë e Brendshme, njësitë e forcave të armatosura dhe ministritë e tjera ende mbështeten te metodat e llogaritjes të bazuara në letër, të cilat janë të ngadalta, të vështira për t’u krahasuar dhe nganjëherë të pasakta. Në këto kushte, ka të ngjarë që të mos zbulohet ndonjë vjedhje e rezervave.
- Megjithë ekzistencën e rregullave dhe procedurave të përgjithshme të zhvilluara për forcat policore dhe ushtarake mbi magazinimin e sigurt, në disa raste, inventaret dhe magazinimet brenda kompanive të ruajtjes dhe sigurisë fizike duken të papërshtatshme. Kjo lejon që AVL-të të shkëmbehen midis rojave pa plotësuar dokumentacionin e nevojshëm dhe nganjëherë lejohet që armët të merren në shtëpi, në kundërshtim me ligjin

Grumbullimi i AVL-ve dhe municioneve

- Iniciativa pasuese të grumbullimit të armëve janë ndërmarrë në Shqipëri që prej vitit 1997 me sukses të dukshëm, duke çuar në dorëzimin nga publiku të më shumë se 200,000 armëve pa leje
- Megjithatë, ciklet e vazhdueshme të grumbullimit të armëve krijuan disa probleme, duke përfshirë:
 - ‘lodhjen nga grumbullimi’ midis publikut, policisë dhe komunitetit ndërkombëtar
 - konfuzion mes publikut në lidhje me rregullat mbi mbajtjen dhe grumbullimin e armëve
 - zbatim jo të rregullt të legjislacionit ekzistues mbi zotërimin nga civilet nga autoritetet

Shkatërrimi i AVL-ve dhe municioneve

- Deri tani është bërë një progres i kënaqshëm për shkatërrimin e AVL-ve dhe municioneve. Gjatë katër-pesë vitet e fundit janë shkatërruar më shumë se 140,000 armë dhe 22,000 ton municione
- Megjithë angazhimet për të shkatërruar armët e tepërta të ndërmarrë ndaj një sërë organizatash dhe forumesh ndërkombëtare, duke përfshirë Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) dhe Kombet e Bashkuara, teprica të konsiderueshme armësh (diku në rëndin prej 80–140,000 njësisë) dhe municionesh mbeten në magazina, pa treguar se kur ose në ç’mënyrë do të shkatërrohen
- Prodhimet e mbetjeve toksike të krijuara si nënprodukte të shkatërrimit të municioneve nuk janë menaxhuar gjithmonë me synimin për të minimizuar impaktin mjedisor.
- Disa njësi të Asgjësimit të Eksplozivëve të Artilerisë brenda Forcave të Armatosura janë trajnuar vetëm për shkatërrimin e një artikulli të veçantë, e megjithatë ata kryejnë shkatërrime të një shkalle të gjërë, pa njohuritë ose pajisjet e nevojshme. Duke vepruar kështu, ato paraqesin një kërcënim serioz për sigurinë e publikut.

Transfertat ndërkombëtare të AVL-ve dhe armëve të tjera konvencionale

- Duke pranuar që zbatimi i legjislacionit dhe rregulloreve kombëtare për kontrollin e transfertave të armëve ka qenë historikisht i dobët, Qeveria Shqiptare është përpjekur të prezantojë rregullore të reja dhe të përmirësuara në këtë fushë. Megjithatë edhe pse është hartuar një ligj i ri dhe i përmirësuar mbi importin dhe eksportin e mallrave ushtarake, ai ende nuk është miratuar nga parlamenti

- Shkalla në të cilën sistemi i kontrollit të eksportit të armëve në Shqipëri përputhet me angazhimet ndërkombëtare të vendit nuk është e qartë, për shkak të mungesës së transparencës nga ana e Qeverisë në këtë fushë.
- Meqënëse Shqipëria ka përfaqësi të kufizuara diplomatike nëpër botë aktualisht ka një fushë shumë të ngushtë veprimi për të siguruar verifikimin efektiv të post-eksportit dhe të përputhshmërisë me çertifikatat e end-userave,

Trafikimi dhe krimi i organizuar

- Shqipëria merr pjesë në një sërë iniciativash rajonale për anti-trafikun, sigurinë e kufirit dhe kundër krimit të organizuar. Shkëmbimet e suksesshme të informacionit mbi trafikun e AVL-ve përmes këtyre kanaleve kanë rezultuar të efektive, edhe për shkak të mbështetjes së profilit të lartë që Qeveria Shqiptare ka dhënë ndaj tyre.
- Sipas Ministrisë së Brëndshme, shumë AVL pa leje të konfiskuara nga policia gjatë punës së saj, më tepër janë trafikuar në vënd sesa kanë patur origjinën nga stoqet e qeverisë shqiptare
- Tipi i artikujve të trafikuar brenda dhe jashtë Shqipërisë ka ndryshuar që prej vitit 2002, me më pak pushkë jo-automatike dhe AK47 të kapura dhe me një numër në rritje të predhave dhe bombave të detonuara të komanduara celularë të konfiskuara.

Drejtësia dhe zbatimi i ligjit

- Kapaciteti i institucioneve të zbatimit të ligjit për të luftuar armëmbajtjen pa leje dhe krimin me AVL është rritur me kalimin e kohës së bashku me reformat për shërbimin kombëtar të policisë, përfshirë prezantimin e njësive dhe strategjive të reja të specializuara në anti-trafik dhe një përpjekje për të adoptuar metoda të policimit në komunitet.
- Sipas ligjit aktual mbi mbajtjen e AVL-ve, një sasi e konsiderueshme e atyre civilëve që zotërojnë armë të paregjistruara janë objekt i ndjekjes penale. Natyra e ashpër e këtij ligji, në një shoqëri e cila pranon mbajtjen e armëve, i pengon punonjësit e policisë në bërjen e arrestimeve dhe disa gjykatës në dhënien e dënimeve të specifikuara në Kodin Penal. Për më tepër, sistemi i burgjeve nuk ka kapacitet për të trajtuar rritjen masive të burgosurve që do të sillte zbatimi strikt i Kodit Penal
- Ekziston një shkallë konfuzioni mes qytetarëve dhe disa nëpunësve të zbatimit të ligjit rreth bazës ligjore për mbajtjen dhe grumbullimin e armëve. Kjo jo vetëm pengon zbatimin efektiv të ligjit në këtë fushë, por mund të kontribuojë në akuzat që punonjësit e policisë dhe gjykatësit kanë qënë objekt mitmarrjeje në shkëmbim të mosarrestimit ose ndjekjes penale të civilëve që zotërojnë armë pa leje

Koordinimi, vazhdueshmëria dhe zhvillimi i politikave

- Qeveria Shqiptare u përgjigj menjëherë dhe vendosmërisht ndaj grabitjes kombëtare të armëve në 1997-ën duke ngritur një komision ndër-departmental të nivelit të lartë për të kordinuar mbledhjet pasuese të armëve
- Përpjekjet më të fundit të Qeverisë Shqiptare për të zbatuar një përgjigje të koordinuar ndaj problemeve të AVL-ve dhe sigurisë në vënd janë penguar nga mungesa e një koordinimi ndër-ministor dhe ndër-departmental dhe ndryshimet e stafit të nivelit të lartë në institucionet qeveritare
- Efektiviteti i mbështetjes ndërkombëtare për aktivitetet e kontrollit të AVL-ve në Shqipëri ka rënë me disa pikë gjatë dekadës së shkuar, si rezultat i koordinimit të dobët midis agjensive ndërkombëtare dhe donatorëve dhe mungesës së angazhimit të qëndrueshëm
- Megjithëse ka bërë progres në kontrollin e brëndshëm të AVL-ve, Qeveria e Shqipërisë shpesh ka mbetur në prapaskenë në zhvillimin e politikave dhe rregulloreve ndërkombëtare, dhe si rezultat shtetet e tjera nuk kanë përfituar nga përvoja e konsiderueshme e vendit

Akronime dhe Shkurtime

FASH	Forcat e Armatosura të Shqipërisë	MM	Ministria e Mbrojtjes
PKSH	Partia Komuniste Shqiptare	MRP	Ministria e Rendit Publik
SHKPE	Shoqata e Kolegjeve të Policisë Europiane	MB	Ministria e Brendshme
AIA	Linja ajrore Ndërkombetare Afrikane	SGAMRP	Sektori i Grumbullimit të Armëve në Ministrinë e Rendit Publik
ISHSN	Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare	MDM	Memorandum Mirëkuptimi
UKSH	Ushtria Kombëtare Shqiptare	AMF	Agjensia e Mirëmbajtjes dhe Furnizimit e NATOs
PPSH	Partia e Punës e Shqipërisë	NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
SDAZE	Skuadra e Depove të Armatimit dhe Zbatimit të Eliminimit	QKÇ	Qendra Kombetare për Çmilitarizim
OBEDZ	Organizata e Bashkepunimit Ekonomik e Detit të Zi	OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
CAM-A	Misioni i Asistencës Doganore në Shqipëri	INTAV	Inisiativa Norvegjeze për Transferrat e Armëve të Vogla
EQL	Europa Qëndrore dhe Lindore	UKÇ	Ushtria Kombëtare Çlirimtare
IEQ	Inisiativa e Europës Qëndrore	IKO	Inisiativa mbi Krimin e Organizuar
KPK	Komiteti i Pajtimit Kombëtar	OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkepunim në Europë
KM	Këshilli i Ministrave	PAMECA	Misioni për Asistencë Policore të Komunitetit Europian në Shqipëri
IPK	Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit, Transparenca Ndërkombëtare	PpP	Partneritet për Paqe
KDFA	Kontrolli Demokratik i Forcave të Armatosura	KRSF	Kompani të Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike
DZHI	Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar (Mbretëria e Bashkuar)	GER	Granatat Eksplozivë Raketë
PD	Partia Demokratike	MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
EÇKP	Edukimi për Çarmatim dhe Kulturë Paqësore	AVL	Armë të Vogla dhe të Lehta
RDK	Republika Demokratike e Kongos	KAVL	Kontrolli mbi Armët e Vogla dhe të Lehta
KE	Komisioni Europian	PKAVL	Projekti i Kontrollit të Armëve të Vogla dhe të Lehta
MAPKE	Misioni për Asistencë Policore të Komisionit Europian	IBEJ	Inisiativa Bashkëpunuese e Europës Juglindore
ETMM	Ekipi Trajnues për Mbështetjen ndaj Municionit	EJ	Europa Juglindore
BE	Bashkimi Europian	SEESAC	Zyra Qëndrore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta e Europës Juglindore
IRJ	Ish-Republika Jugosllave	SHISH	Agjensia Kombëtare e Sherbimeve Inteligjente
GDP	Prodhimi Brendshëm Bruto	PS	Partia Socialiste
PKB	Prodhimi Kombëtar Bruto	MRFS	Mbështetje për Reformën në Fushën e Sigurisë
PPG	Programi Pilot i Gramshit	SMIP	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Pergjithshëm
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufijve	UÇPMB	Ushtria Çlirimtare e Presheves, Medvedjes dhe Bujanovacit
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Asistencës Trajnuese për Hetimet Kriminale	UNDDA	Departamenti i Kombeve të Bashkuara për Çështjet e Çarmatimit
QNZHPM	Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migracionit	UNDP	Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
SNVK	Studimi Ndërkombëtar i Viktimave të Krimin	UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatet
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin	UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijet
IRLPRKB	Instituti për Raportet e Luftës dhe Paqes: Raportet mbi Krizat në Ballkan	UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës	UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogenë dhe Krimin e Organizuar
LSI	Levizja Socialiste për Integrim	UNPoA	Programi i Veprimit të Kombeve të Bashkuara
MANDAPS	Sistemi i Mbrojtjes Ajrore të Transportueshëm nga Njeriu	USAID	Agjensia e ShBA për Zhvillim Ndërkombëtar
ESHPK	Elementi Shumëkombëtar i Politikave Këshilluese	AKZH	Armet në Këmbim për Zhvillim
MEICO	Kompania Ushtarake Eksport Import	BEP	Bashkimi Europian Perendimor
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme	OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë

